

**TEMA: NR.3: ZHVILLIMI PROFESIONAL I ARSIMTAREVE BASHKEPUNTOREVE PROFESIONAL  
EDUKSTOREVE STAFIT UDHEHEQES**

| <b>Tema nr. 3: ZHVILLIMI PROFESIONAL</b>   |                                                                                                                                                                                                                                                              |
|--------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Nr. Treguesi i cilësisë</b>             | <b>Temat</b>                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>3. 1 Planifikimi i mësimdhënies</b>     | <i>Përkrahja dhe ndjekja e planifikimit të mësimdhënies<br/>Planifikimet individuale të mësimdhënies<br/>Shpërblimi i përvojave dhe informative gjatë planifikimit<br/>Orari i mësimi</i>                                                                    |
| <b>3. 2 Procesi mësimor</b>                | <i>Formati dhe metodat mësimore<br/>Përdorimi i TIK-ut gjatë mësimi<br/>Zgjedhja e detyrave, aktiviteve dhe resurseve<br/>Mardhëniet interaktive midis mësimdhënësve dhe nxënësve<br/>Qasja e mësimdhënësve dhe nxënësve<br/>Ndjekja e procesit mësimorë</i> |
| <b>3. 3 Përvojat e nxënësve nga mësimi</b> | <i>Mjedisi i mësimi<br/>Atmosfera e mësimi<br/>Nxitja e nxënësve për marjen e përgjegjësisë<br/>Mardhëniet interaktive të nxënësve midis veti dhe me të riturit në shkollë</i>                                                                               |
| <b>3.4 Kënaqja e nevojave të nxënësve</b>  | <i>Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve<br/>Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në mësim</i>                                                                                                                                               |

|                                                 |                                                                                                                          |
|-------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>3. 5 Notimi si pjesë e mësim</b>             | <i>Politika e shkollës për notim<br/>Metodat dhe format e notimit<br/>Shfrytëzimi i i nformatave nga notimi në mësim</i> |
| <b>3. 6 Informimi për përparimin e nxënësve</b> | <i>Informimi i prindërve për përparimin e nxënësve</i>                                                                   |



### 3.1 Planifikimet e mësimdhënësve

| Temat                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Mbështetja dhe ndjekja e planifikimit të mësimdhënësve</b>    | <i>Duke u bazuar në udhëzimet e Byrosë për zhvillim të arsimit dhe Ministrisë së arsimit dhe shkencës, mësimi dhe mësimdhënia në shkollën fillore “Bedri Tairi” realizohet në gjuhen shqipe. Me procedurat e veçanta të planifikuara nga drejtori, shërbimi profesional ose organet profesionale. Duke ju përshtatur udhëzimeve të agjencionit për zhvillim të arsimit dhe edukimit të Bashkimi Evropian të gjithë arsimtarët kanë planet globale, tematike-mujore dhe ditore, që i ja mundësojnë prezentimin konkret me drejtime të qarta para nxënësve, rezultatet mësimore dhe arritjen e rezultateve.</i> |
| <b>Planifikimet individuale të mësimdhënësve</b>                 | <i>Qëllimet për individualizimin e mësimdhënies janë arritja e rezultateve të pritura dhe mënyra e notimit apo vlerësimin e nxënësve me anë të notimit formativ duke e angazhuar nxënësin të mësojë për mësim dhe jo për notë.</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>Këmbimi i përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit</b> | <i>Përvojat dhe informacionet e aktiviteteve profesionale në shkollë mvaren nga komunikimi ndërmjet mësimdhënësve ndërrimit të idejave dhe mendimeve për planifikimin me anë të teknologjive të të ndryshme të informimit dhe komunikimit për punën në shkollë.</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Orari i mësimi</b>                                            | <i>Sa i përket orarit të mësimi, për të kujdeset dhe e bën shërbimi profesional në bashkëpunim me arsimtarët, duke respektuar interesin e nxënësve.</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |

### Burimet e të dhënave

*Burimet e të dhënave janë të përqëndruara nga planifikimet vjetore, tematike dhe ditore, poashtu listat për evidence duke u përqëndruar në instrumentet për ndjekjen e planifikimit të mësimdhënies, zhvillimin e bisedave nga kreu i lartë i shkollës drejtori, poashtu pedagogu, psikologu mësimdhënësit (arsimtarët) dhe shërbimi professional administrative, shfrytëzimi i proçesverbaleve të ndryshme nga mbledhjet e grupeve profesionale.*

### 3.2 Procesi mësimor

|                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|----------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Temat</b>                                                   | <i>Arsimtarët gjatë mësimdhënies përdorin metodat më moderne të përshtatura në metodat e shumë shteteve të Bashkimit Evropian. Mvarësisht nga lënda që ligjerohet arsimtarët kanë formuluar metoda dhe forma të llojllojshme duke qenë më produktiv zhvillimi i orës. Një ndër metodat është metoda interaktive, nxënësit në disa raste ndahen në grupe që kënaqin nevojat e tyre dhe mësimdhanja është më produktive.</i>             |
| <b>Format dhe metodat mësimore</b>                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Përdorimi i TIK-ut gjatë mësimi</b>                         | <i>Shkolla fillore “Bedri Tairi” është e paisur me kompjuter shumica e arsimtarëve përdorin teknologjinë më të re arsimore me anë të kompjuterit dhe paisjeve tjera teknologjike që mundësojnë një mësimdhënie bashkëkohore.</i>                                                                                                                                                                                                       |
| <b>Zgjedhja e detyrave,aktiviteteve dhe resurseve</b>          | <i>Angazhimi i nxënësve me detyra qofshin ato të klasës apo të shtëpisë mvaret nga lënda, ku disa lëndë kërkojnë edhe eksperimente konkrete përdorimin e materialeve të ndryshe, mësimdhënësit shfrytëzojnë resurse jo vetëm nga libri dhe tekstet tjera shkollore që janë paraparë në klasë por bëhet edhe me metodat më të reja të shfrytëzimit të internetit dhe mediave ku nxënësi përdor edhe fantazitë e veta gjatë punimit.</i> |
| <b>Mardhëniet interaktive midis mësimdhënësve dhe nxënësve</b> | <i>Raportet interaktive nërmjet arsimtarëve dhe nxënësve janë në nivel të duhur, ku idetë, qëllimet dhe rezultatet ndahen mes mësimdhënësit dhe nxënësit. Raportet janë të mira pa dallim gjinor, social, etik ose përkatësi fetare.</i>                                                                                                                                                                                               |

|                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-----------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Sjellja e mësimeve ndaj nxënësve</b> | <i>Kur jemi te sjellja e mësimeve dhe nxënësve kemi dallime të mëdha duke pasur parasyshë hiperaktivitetin e nxënësve sidomos kohën e fundit, metodat e praktikimit për të marrë masë janë të caktuara dhe po respektohen në shkollë repte është e ndaluar malltretim qoftë fizik apo psikik i nxënësve. Për të aritur qëllimet mësimeve përdoren metodat tjera konsultime me prindërit, dënime me nota të dobta largime nga ora, konsultime me pedagogun etj.</i> |
| <b>Ndjekja e procesit mësimor</b>       | <i>Procesi edukativo-arsimor në shkollë ndiqet nga ana e grupit profesional, drejtori, pedagogu psikologu ku edhe në praktikë shifet bashkëpunimi ndërmjet mësimeve dhe grupit profesional, e njëjta është edhe me grupin profesional dhe nxënësit.</i>                                                                                                                                                                                                            |

#### **Burime të dhënave**

*Organet e shkollës bëjnë ndjekjen dhe vlerësimin e planifikimit të orës mësimore, bëjnë ndjekjen dhe vlerësimin e realizimit të orës mësimore, bëjnë ndjekjen dhe vlerësimin e zhvillimit të orës mësimore, bëjnë ndjekjen dhe vlerësimin e kriimit të atmosferës në klasë, bëjnë ndjekjen dhe vlerësimin e punës së mësimeve për notimin e nxënësve, bëjnë ndjekjen dhe vlerësimin e komunikimit të mësimeve dhe nxënësve.*

### 3.3 Përvojat e nxënësve

| Temat                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Ambienti për mësim</b>                      | <p><i>Në shkollën fillore “Bedri Tairi” ambienti për mësim është në nivel shumë të mirë, mësimi zhvillohet në mënyrë klasore, nxënësit janë të motivuar dhe kanë vullnet për punë. Sa i përket klasave janë të paisura me drasa të bardha, banka karike te vjetruara, në disa kabinete ka edhe mjete konkrete punuese.</i></p> <p><i>Kur jemi te higjiena shkolla jonë i kushton rëndësi të madhe pastrimit për zhvillimin e mësimin në kushte jashtzakonisht të pastërta për të cilën kujdesen shërbimi teknik.</i></p> |
| <b>Atmosfera për mësim</b>                     | <p><i>Sa i përket atmosferës për mësim gjatë zhvillimit të anketimit të 32 nxënësve, ku gjashtë nxënës mendojnë se atmosfera është e mire, njëzet e pesë nxënës mendojnë se atmosfera është mesatarisht dhe asnjë nxënës nuk mendon se atmosfera është e keqe.</i></p>                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>Shprehja e mendimit të lirë të nxënësve</b> | <p><i>Sa i përket shprehjes së lirë të nxënësve, gjatë anketimit të 32 nxënësve 18 nxënës janë përgjigjur me PO dhe 13 nxënës janë përgjigjur me JO. Ku tregon një afërsi të madhe që është për tu merakosur sa i përket shprehjes së lirë të nxënësve.</i></p>                                                                                                                                                                                                                                                          |

**Sjellja e nxënësve**

*Gjithashtu edhe sa i përket sjelljes së nxënësve duke zhvilluar biseda me mësuesin ata shprehin mendimin se sjellja gjatë viteve të fundit po ndryshojnë kah më e keqja duke reflektuar në zhvillimin e mësimit dhe jashtë mësimit në oboret e shkolles. Shkaqet janë akoma të pa qarta mund të jenë jashtë shkolle nga interesimi i dobët i prindërve dhe nga teknologjia apo përdorimi i tepërt i kompjuterit jashtë orarit të shkollës.*

**Burimet e të dhënave**

*Burimet e të dhënave janë të mvarura nga anketimi i nxënësve bisedimi në grupe me ta, anketimi i mësuesve, qasjet e evidencës së shërbimit profesional dhe dosjetë ndryshme.*

### 3.4 procesi mësimorë

| Temat                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve</b>           | <i>Kuadri arsimor dhe shërbimi profesional i identifikojnë në mënyrë sistematike nevojat dhe problemet arsimore që paraqiten tek nxënësit dhe ata menjëherë marín masa për tejkalimin e atij problemi. Në rast nevoje për tejkalimin e kësaj problematike kyçen edhe kujdestari i klasës dhe shërbimet profesionale në shkollë.</i> |
| <b>Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në mësim</b> | <i>Mësimdhënësit gjatë procesit edukativ shfrytëzojnë teknika dhe metoda të ndryshme për të qenë sa më të qartë dhe korrekt ndaj nxënësve. Gjatë notimit përdorin metoda dhe teknika të ndryshme për ti motivuar nxënësit edhe më tutje për punë të pamvarur të tyre.</i>                                                           |

### Burimet e të dhënave

*Anketa me nxënësit, biseda me bashkësinë e nxënësve, me prindërit me mësimdhënësit, qasje në dosjet e nxënësve, qasje në evidencën e shërbimit profesional, program i punës dhe raportet e bashkësisë së nxënësve.*



### 3.5 Notimi si pjesë e mësim

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Temat</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | <i>Shkolla fillore “ Bedri Tairi” i zbaton dispozitat ligjore sa i përket notimit të nxënësve. Përveç akteve ligjore shkolla jonë ka edhe kriteret e standardizuara sipas Byrosë për zhvillimin e arsimit duke qenë çdoher në kontakte me prindërit për informimin e notimit.</i>             |
| <b>Politika e shkollës për notim</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Format dhe metodat për notim</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | <i>Secili arsimtar ka metodat dhe format e veta të notimit siç janë: notimi individual, vetëvotimi i nxënësve, teste, notimi me shkrim, mbajtja e evidences së nxënësve, kontrollimi i detyrave, sjellja e tj. Ku të gjitha këto mundësojnë aritjen e rezultateve më të mira të nxënësve.</i> |
| <b>Shfrytëzimi i informatave nga notimi në mësim</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | <i>Arsimtarët japin informatat kryesore gojore me shkrim dhe demonstruese se për çka bëhet fjalë.<br/>Rëndësi të veçantë u vihet të ariturave të nxënësve dhe identifikimin e aktiviteteve të ardhshme që do të zbatohen në mësim.</i>                                                        |
| <b>Burimet e të dhënave</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <i>Burimet e të dhënave janë të kancentruara në evidencat padagogjike, mjetet për notim si (testet e diturisë, testet kontrolluese, listat me pika) procesverbalet e grupeve profesionale dhe këshillit arsimor, intervista individuale me mësimdhënësit, mendimet e prindërve dhe nxënësve dhe mbledhjet e realizuara mes arsimtarëve dhe prindërve.</i> |                                                                                                                                                                                                                                                                                               |

### 3.6 Raporti për përparimin e nxënësve

|                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Temat</b>                                           | <i>Sa i përket informimit të prindërve secili arsimtar bazohet në grombullimin e informative për përparimin e nxënësit ose e kundërta. Secili arsimtar ka metodat e veta siç janë mbledhjet prindrore (grupore), takimet individuale me prindërit, bisedime telefonike dhe informime me shkrim. Poashtu nga prindërit kërkohet që të japin informata kthyesë pas raportit për aritjet ose ngecjet e fëmijëve të tyre.</i> |
| <b>Informimi i prindërve për përparimin e nxënësve</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |

#### Burimet e të dhënave

*Burimet e të dhënave koncentrohen në dokumentacionin dhe evidencat pedagogjike, anketa dhe intervista me prindërit dhe evidence e mesimdhënësve na mbledhjet e realizuara prindrore.*

### Anët pozitive dhe negative

#### Anët negative

*-Nxënësit me nevoja ndryshe janë të inkuadruar në procesin edukativo-arsimor, mirpo shkolla ka nevojë për ndihmë profesionale që ti tejkalojë problemet me nxënësit që janë me nevoja të kufizuara (logoped, defektolog) edhe pse numri është shumë i vogël.*

*-Shkollës i mungon salla sportive që ndikon te nxënësit negativisht për ndjekjen e ushtimeve sidomos gjatë stinës së dimrit për zhvillimin e drejt të nxënësit.*

*- Mungesa e hapsirave ne shkollë për realizimin e mësimit kabinetik.*

*-Sa i përket bashkëpunimit të prindërve me mësime dhënësit (kujdestarët e klasave), ku trekëndëshi mësime dhënë, prind dhe nxënës nuk funksionon aq sa duhet që ndikon drejtpërdrejt në procesin edukativo-arsimor.*

## Përfundimi

### Analiza e rezultateve

- Në shkollën fillore “Bedri Tairi” puna dhe aktiviteti i mësimeve vazhdimisht ndjeket nga shërbimi profesional, bëhen këmbim i mendimeve, përvojave dhe ideve për planifikim më të suksesshëm të mësimit;*
- Atmosfera për punë është në nivel të duhur, raportet dhe sjellja mes mësimeve dhe nxënësve janë të mira;*
- Mënyra e zhvillimit të procesit edukativo-arsimor mundëson nxitjen e nxënësve për punë të mëtutjeshme dhe të pamvarur të tyre, ku me kohë identifikohen nevojat arsimore të nxënësve;*
- Notimi ose vlerësimi i nxënësve kryhet sipas standardeve dhe kriterëve të duhura në shkollë;*
- Orari mësimorë përpilohet nga shërbimi profesional ku në rend të parë vihet interesi i nxënësit;*

### **Aktivitet e ardhshme që do të kyçen në planin zhvillimor të shkollës**

*-Prioritet për aktivitetet e ardhshme shkolla fillore “Bedri Tairi” parasheh bashkëpunim më intenziv me prindërit duke i aplikuar të gjitha aktivitetet e mundshme, si kontaktet grupore (mbledhjet prindrore), takimet individuale, kontaktet telefonike, programet festive që të ketë rezultate pozitive direkt te nxënësi.*

*-Sa i përket nxënësve me nevojat të kufizuara shkolla “Bedri Tairi” në të ardhmen do të vazhdojë të ikuadrojë në procesin edukativo-arsimor por edhe do të kërkojë vazhdimisht ndihmë nga institucionet përkatëse si MASH-i dhe Komuna e Sarajit. Që nxënësve tu mundësohet lehtësim për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor (paralele speciale)*

